

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
Planprogramet – 2017-2022

-Programi i STUDIMEVE –KOMUNIKACION DHE TRANSPORT - Master (Msc)

Titulli i lëndës:	PROJEKTIMI I KOMUNIKACIONIT		
Përshkrimi i lëndës	Kuptimi i projektimit të transportit – komunikacionit. Projekti-mi i trafikut në komunikacionin rrugor. Detyrat projektuese për projekte të ndryshme, projektimi i trafikut në: organizimin e transportit të udhëtarëve (transporti ndërurban, transporti urbano-periferik, transporti urban – hekurudha urbane, metro-ja, tramvaji, autobusi, minibusi, taksi), në organizimin e transportit të mallrave (ndërurban, urban – distribuimi (shpërndar-ja)). Projektimi i infrastrukturës së trafikut (rrjeta rrugore, rrjeta urbane, parkingjet, sistemet në ndërmarrje). Zgjidhjet ideore, projektet ideore, projektet ekzekutuese, projektet e mirëmbajt-jes, të organizimit, të eksploatimit dhe të funksionit. Elaboratet dhe kushtet për marrjen e lejes së lokacionit, elaboratet dhe projektet për fitimin e lejes për ndërtim. Lista e shpenzimeve për dëshmimin e përmasave të investimeve. Etapat e realizimit të projektit, afati i përdorimit të projektit.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmia e projektimit të trafikut dhe transportit në të gjitha specifikat që e përcjellin këtë veprimtari kreative të ekspertit të kësaj lëmie. Të aftësohen për përballimin e problemeve të projektimit të të gjitha llojeve të udhëkryqeve (në nivel, disnivel, rrethore), projektimin e pjerrtësive gjatësore dhe tërthore të rrugës si dhe përballimin e superelevacionit, përvetësimin e projektimit të zgjerimeve të domosdoshme në kthesa të rrugëve si dhe kthesave të mëdha (afër 180°) (serpenti-nave), projektimin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal të rru-gëve dhe segmenteve rrugore, si në rrugë ndërurbane po ashtu edhe në rrugë urbano-periferike dhe rrugë urbane, projektimin me sukses të infrastrukturës përcjellëse të rrugëve (rigolat, bankinat, etj.)		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët do të përvetësojnë: Llojet e projekteve (ideore, krye-sore, të realizimit; projektimin e udhëkryqeve në nivel dhe në disnivel, udhëkryqeve rrethore; projektimin e zgjerimit të rrugë-ve në kthesa, superelevacionin, projektimin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal etj.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	2	4
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	1	10	10
Kolokuiume, seminare	8	1	8
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	5	20
Përgatitja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet ,etj	2	2	4
Totali			138

Metodologjia e mësimeve:	Ligjërata përmes prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, ushtrime në terren, punime seminarike, teste, diskutime, etj.	
Raporti në mes të studimit teoritik dhe praktik:	Pjesa teorike (%)	Pjesa praktike (%)
	50%	50%
Literatura bazë:	1. Dr.sc. Sadullah Avdiu, <i>Projektimi i komunikacionit</i> , FIM, Prishtinë, 2013.	
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>A Policy on Geometric Design of Highways and Streets</i>, AASHTO, 2004. 2. A. Sulçe, E. Kazazi: <i>Projektimi i rrethrotullimeve - Mënyra e projektimit dhe vlerësimit të kryqëzimeve me qarkullim rrethor</i>, albPAPER, Tiranë, 2008. 3. B. Stanić, P. Zdravković, ...: <i>Elementi saobraćajnog projektovanja - Horizontalna signalizacija, Vertikalna signalizacija</i>, SF, Beograd, 1997. 4. G. Kos: <i>Prometno modeliranje</i>, FPZ, Zagreb, 2010. 5. I. Dadić, G. Kos: <i>Prometno i prostorno planiranje</i>, FPZ, Zagreb, 2007. 6. I. Legac: <i>Cestovne prometnice I - Javne ceste</i>, FPZ, Zagreb, 2006. 7. I. Legac: <i>Cestovne prometnice II - Raskrižja javnih cesta</i>, FPZ, Zagreb, 2007. 8. J. V. Korte: <i>Osnove projektovanja gradskog i međugradskog put-nog saobraćaja</i>, GK, Beograd, 1968. 9. J. Božičević: <i>Ceste I i II</i>, FPZ, Zagreb, 1993. 10. L. Babameto: <i>Transporti - Teknika, Teknologjia dhe Ekonomia në llojet e Transportit</i>, Logoreci, Tiranë, 1997. 11. M. Anžek: <i>Prometnotehnoško projektiranje</i>, FPZ, Zagreb, 2009. 12. M. Maletin: <i>Planiranje i projektovanje saobraćajnica u gradovima</i>, Orion Art, Beograd, 2005. 13. R. Dončeva: <i>Patišta - Projektiranje patni jazli</i>, Kniga 2, GF, Skopje, 2004. 14. <i>Roundabouts: An Informational Guide</i>, US. Department of Transportation, 2000. 15. <i>Standartet për Projektimin dhe Ndërtimin e Rrugëve Shqiptare - Manuali për Projektimin e Rrugëve Shqiptare</i>, MPRrSh 6 - Shenjat dhe Vijëzimet Rrugore, Eptisa, Tiranë. 16. Ž. Korlaet: <i>Uvod u projektiranje i građenje cesta</i>, GF, Zagreb, 1995. 	

Titulli i lëndës:	TEKNOLOGJIA E TRANSPORTIT		
Përshkrimi i lëndës	Hyrje mbi teknologjitë e transportit të mallrave dhe udhëtarëve Infrastruktura dhe logjistika e teknologjive bashkëkohore Teknologjia me kontejner Teknologjia unimodale-konvencionale Teknologjia bimodale Teknologjia integrale Teknologjia intermodale Teknologjia multimodale Teknologjitë (R0-R0, Lo-Lo ,Ro-Lo , Fo-Fo, Hucke Pack,) Teknologjia modalhor Teknologjia modulare Teknologjia e autostradës lëvizëse Teknologjia e transportit të udhëtarëve		
Qëllimet e lëndës:	Për të kuptuar aspektet dhe teknologjitë për bartjen e mallrave dhe njerëzve		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Te aftësohen studentet për kryerjen e punëve profesionale si dhe të atyre shkencore në institucione hulumtuese.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	5	2	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren	2	3	6
Kollokfiime,seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	3	5	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	6	6
Përgaditja përfundimtare për provim	2	8	16
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezntimet ,etj	2	2	4
Totali			138
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjëratat dhe konsultimet. Ligjëratat me anë prezntimeve, mësimdhënie interaktive, ushtrime, punë ekipore, studime për çështje të veçanta, punë të pavarur nga kandidati, vizitë në terren, mbrojtje e detyrave projektuese		
Metodat e vlerësimit:	Testim, gjatë vitit ose provimi përfundimtar, aktiviteti dhe angazhimi		
Literatura bazë:	<i>Prof. dr. Musli Bajraaktari "Teknologjia e transportit</i>		
Literatura shtesë:	Listoni literaturën e rekomanduar/shtesë. 1. Flaherty, C.A.: <i>Transport planning and Traffic Engineering</i> , Londer, 1997 2. Lay, M.C : <i>Ways of the world</i> . Sydney, Primavera press, 1993 3. Zupanoviq, I.: <i>Tehnologjia cestovnog prometa</i>		

Titulli i lëndës:	SIGURIA NË KOMUNIKACION II		
Përshkrimi i lëndës	Materia që shtjellohet në këtë kurs paraqet vazhdimin e lëndës siguria në komunikacion I dhe trajton ndeshjen ndërmjet mjeteve, analizën rrjedhës së aksidenteve rrugore dhe konstatimet lidhur me shkaktarët e aksidenteve.		
Qëllimet e lëndës:	Njohja dhe thellimi i diturisë në analizën dhe preventiven e aksidenteve në komunikacion		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> - dijë zhvillimin e komunikacionit rrugor dhe aksidentet në komunikacion - analizoj procesin e ndeshjes - dijë metodat për caktimin e shpejtësive relevante gjatë procesit të ndeshjes - dijë elementet e ngasjes së automjeteve - jetë në gjendje të përdorë metodat adekuate për përcaktimin e shkallës së dëmtimit të cilat shkaktohen gjatë aksidenteve 		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	10	20
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	10	5
Ushtrime në teren	2	5	10
Kollokfiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2.5	15	37.5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj	0	5	10
Totali			143.5
Metodologjia e mësimdhënies:	Materia e paraparë në këtë kurs shtjellohet përmes ligjëratave në mënyrë elektronike, diskutimeve me student, punimeve seminarike dhe vizitave në organizatat prodhuese.		
Raporti në mes të studimit teotik dhe praktik:	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	50%		50%
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. A.Geca "Siguria në komunikacion I" 2009 2. A.Geca "Siguria në komunikacion II" 2011 3. A.Geca Analiza dhe parandalimi i aksidenteve ne komunikacionin rrugorë I+II, 2011 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prof.dr.Franko Rotim. Elementi Sigurnosti Cestovnog Prometa (Pjesae I – rë, e II – dytë dhe e III – tretë), Zagreb, 1991 2. Dr. Radoslav Dragaq, "Bezbednost drumskog saobraqaja III", Beograd, 1999. 		

Titulli i lëndës:	SINJALIZIMI NË KOMUNIKACION		
Përshkrimi i lëndës	Treguesit e efikasitetit të punës së udhëkryqit me sinjale ndriçuese. Faktorët themelore të punës së udhëkryqit me sinjale ndriçuese. Procedimi i projektit të mënyrës së koordinuar të sinjaleve ndriçuese. Llogaritja e zhvendosjes së kohës së gjelbër. Elementet e përmirësimit të dirigjimit në komunikacion në zona të urbanizuara. Praktika aktuale botërore. Praktika aktuale në shtetet e zhvilluara.		
Qëllimet e lëndës:	Të jipen njohuri mbi dirigjimet e sistemeve të përbëra si dhe programet më të sofistikuar të cilat zbatohen sot në Botë. Pastaj, të trajtohen përpilimet e planeve dhe programeve të sinjalizimeve për koridore të sinkronizuara. Së fundi, të jipen vlersimet e niveleve të shërbimeve për udhëkryqe në ato koridore, etj.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë identifikimin e sistemeve të përbëra në komunikacion, • Të bëjë simulimin e programeve të ndryshme të cilat zbatohen sot në Botë për dirigjim të sistemeve të përbëra, • Mbi bazën e ngarkesave të matura në trafik din të bëjë përgaditjen përpilimin e planeve të sinjalizimit për çfarëdo koridori me sinjalizim të koordinuar, • Sipas rezultateve të fituara më lartë për koridor të tillë të koordinuar është i aftë të bëjë vlerësimin e nivelit të shërbimeve, etj. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1/2	10	5
Ushtrime në teren	1	5	5
Kollokfiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	8	24
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	6	1	5
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
Totali			138
Metodologjia e mësimdhënies:	Materia e paraparë në këtë kurs shtjellohet përmes ligjëratave në mënyrë elektronike, presentimet grupore, diskutimeve me studentë, punimeve seminarike dhe vizitave në terren.		
Raporti në mes të studimit teotik dhe praktik:	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	70%		30%
Literatura bazë:	1. Perjuci Xh., Leksione nga Rregullimi dhe Dirigjimi i Qarkullimit në Komunikacion, Prishtinë, 2004.		
Literatura shtesë:	2. Osoba M., etj., Upravljanje Saobraćajem Pomocu Svetlosnih Signala, 1999. 3. Akcelik R., Traffic Signals-Capacity and Timing Analysis Victoria, 1981.		

Titulli i lëndës:	KONTROLI AUTOMATIK NË TRAFIK DHE TRANSPORT		
Përshkrimi i lëndës	Konceptioni dhe përkufizimet bazë të kontrollit automatik në trafik dhe transport. Strukturat themelore të sistemit dhe kontrolli automatik. Modelimi matematik i kontrollit të sistemeve. Kontrolli i disniveleve. Kontrolli i variablave të gjendjes. Kontrolli inteligjent i trafikut.		
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me metodat dhe sintezat e kontrollit të sistemeve lineare të vazhdueshme në kohë dhe fushat e frekuencave.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> • Të njohë qasjet e ndryshme teorike dhe metodologjike të kontrollit automatik në trafik dhe transport. • Të vlerësojë interpretimet e fenomeneve në trafik dhe transport. • Të zhvillojë studime të pavarura dhe kritike në transport 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	6	6
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiime, seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	8	24
Përgatitja përfundimtare për provim	4	5	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet ,etj	0	0	0
Totali			139
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezentimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%) 50%	Pjesa praktike (%) 40%	Ardhja 10%
Literatura bazë:	[1] Dr. sc. Beqir Hamidi, "Kontrolli automatike në trafik dhe transport", Sllajdet, Prishtinë, 2016 [2] Garrett, T. K; K. Newton; W. Steds: "The Motor Vehicle", Reed Educational and Professional Publishing Ltd, 2001		

Lënda:	KËRKIME OPERACIONALE		
Qëllimet e lëndës:	<p>Në veprimtaritë ekonomike të individëve, ndërmarrjeve apo kompanive të ndryshme, ndeshen situata ku ka rrugë të shumta e të ndryshme veprimi për menaxhimin e tyre. E mira është të gjindet ajo rrugë që realizon sipas situatës konkrete diku shpenzimet më të vogla, diku fitimin më të madh, një herë kohën më të shkurtër të realizimit të objektivit, një herë tjetër shfrytëzimin maksimal të makinerive në dispozicion etj. Shpesh realizimi i qëllimeve të mësipërme përkon me zgjidhjen e problemeve të ndryshme të optimizimit në modele matematike që përfaqësojnë situatën praktike në studim. Prandaj dega e matematikës që merret me shtrimin dhe zgjidhjen e problemeve të tilla është Kërkimet operacionale.</p> <p>Shumë lëmenjë shkencorë hulumtojnë, krijojnë dhe zhvillojnë metoda dhe mjete në bazë të cilave është e mundshme të zgjidhen problemet dhe detyrat e caktuara.</p> <p>Me këtë problematikë merren edhe Kërkimet operacionale, me qëllim të përcaktimit të zgjidhjeve dhe marrjes së vendimeve më optimale udhëheqëse, të planifikimit, realizimit dhe vazhdueshmërisë së tyre dhe shfrytëzimit më të mirë të resurseve ekzistuese në të gjitha lëmitë dhe sistemet.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të dijë mbi konceptet dhe veprimet, 2. Bëj modelimin matematikor të të problemeve të transportit dhe fenomeneve ekonomike, 3. Të aplikoj metodat e mundshme të analizave kuantitative për zgjedhjen e problemeve praktike, 4. Të analizoj rolin, vendin, rëndësinë dhe mënyrën e shfrytëzimit të metodave të transportit të programimit linear për marrjen e vendimeve udhëheqëse, 5. Të zbatoj dhe vlerësoj metodat e programimit linear në procesin e vendim marrjeve për përmirësimin e afarizmit të ndërmarrjeve etj, 6. Të njihet me teorinë e grafeve dhe optimizimet në rrjeta. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1		1
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	8	16
Përgaditja përfundimtare për provim	15		15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet, prezentimet ,etj	1		1
Totali			119

Metodologjia e mësimëdhënies:	Ligjërata, puna në grupe të studentëve, punë interaktive, diskutim i çështjeve me interes, punë individuale me qëllim të provokimit të kreativitetit personal. Përveç teksteve që prezanton konceptet themelore, studentet inkurajohen që të hulumtojnë dhe lexojnë edhe artikuj nga interneti, sipas kapitujve përkatës. Ata do të marrin detyra seminarike (2) në ligjërata dhe kanë për obligim të zgjedhin detyrat e shtëpisë të cilat i marrin gjatë orëve të ushtrimeve. Studentët gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve do të prezantojnë punën individuale dhe grupore.	
Raporti në mes të studimit teoritik dhe praktik:	Pjesa teorike (%)	Pjesa praktike (%)
	50%	50%
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Justina Pula “Metodat e transportit të programimit linear”, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, 2007 2. Shpëtim Shehu, “Kërkime operacionale”, TEMPUS, Universiteti Politeknik, Tiranë, 2004 3.Th. Mitre, B. Ruseti, “Matematika e zbatuar”, Fakulteti Ekonomik, Tiranë, 2008 	

Lënda:	TELEMATIKA RRUGORE		
Përshkrimi i lëndës	<p>Termet dhe shtrirja e telematikës rrugore. Procesi i rregullimit të trafikut automatik. Shtresimi dhe topologjia e rrjetit. Rregullimi i shpërndarë dinamik në hapësirë dhe kohë. Algoritmet e kontrollit (rregullimit). Modelet për vlerësimin e efektivitetit të aplikimit. Mirëmbajtja e sistemeve, pajisjeve dhe teknologjisë së funksioneve të transportit. Aplikimi i njohurive në fushën e telematike dhe automatizimin e proceseve të transportit që kanë të bëjnë me zgjidhjen (dizajnimin) e problemeve aktuale të trafikut në praktikë në objektet në veprim. Aplikimi i mbështetësve softuerike ekspert (SW inteligjentë për ekspertët e trafikut - LISA + , SYNCHRO , HCS, SCOOT , SPOT , MATRIX , ...) për të përmirësuar fluksin në udhëkryqet dhe rrjetin rrugor.</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Sistemet telematike paraqesin pjesën përbërëse të sistemeve informative në ndërmarrjet transportuese dhe publike. Si të tillë mundësojnë marrjen e të dhënave të caktuara të nevojshme për përlllogaritjen e parametrave të punës në kohë dhe hapësirë në bazë të të cilave vlerëson rezultatet e punës të grupit të punës të automjeteve ose të parkut të makinave me qëllim të marrjes së vendimeve gjegjëse të cilat do të sjellin rritjen e kualitetit të shërbimeve transportuese dhe publike.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Brenda këtij moduli studentët do të jenë të njoftuar me disa nga konceptet themelore të Telematikës Rrugore. Qëllimi i këtij moduli është që të shqyrtojnë telematikën rrugore më në detaje. Objektivat e detajuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i kushteve të telematikës rrugore, - Studimi i metodologjive dhe protokolleve për menaxhimin, transmetimin, marrjen dhe administrimin e informacionit në mes të automjeteve dhe të infrastrukturës së transportit rrugor, - Studimi i kushteve të komunikimit pa tela mes elementeve të trafikut, - Aplikimi i zgjidhjeve telematike të trafikut që qëndrojnë në kryqëzimin ndërmjet Shkencave Kompjuterike, Telekomunikimeve dhe Komunikacionit Shkencës. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet)			
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2		2
Kollokuiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	3	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	6	6

Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5	2	10
Projektet, prezentimet, etj.	2	1	2
Totali	2	3	6
-Format/ Metodat e mësimdhënies	Materia e paraparë në këtë kurs shtjellohet përmes ligjëratave në mënyrë elektronike, diskutimeve me studentë, punimeve seminarike dhe vizitave në terren.		
-Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:	Pjesa teorike	Pjesa praktike	
	60%	40%	
-Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë	<p>[1] Pajaziti, A.: Traffic Telematics, Authorized Lectures, Prishtina, 2015.</p> <p>[2] Anžek, Mario: Cestovna Telematika, Sveucilište u Zagrebu, FPZ, Autorizirana predavanja, Zagreb 2008.</p> <p>[3] Gordon, R.L., Reiss, R.A., Haenel, H., Case, E.R., French, R.L., Mohaddes, A., Wolcott, R.: Traffic Control Systems Handbook, Final Report, FHWA, 1996</p> <p>[4] Pignatoro, L.J.: Theory and Practice. Traffic Engineering, 1990</p> <p>[5] Corids (2004) Transport Telematics Application,</p> <p>[6] Mikuluski J. Tools of transport telematics. Springer, London</p>		

Titulli i lëndës:	TRAFIKU DHE MJEDISI			
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ofron njohuri mbi ambientin dhe ndotjen, ndotja nga automjetet ne komunikacion, ndotja nga gazrat e mjeteve në komunikacion, ndikimi i ajrit të ndotur, krahasimi i ndotjes nga automjetet me derivate të ndryshme djegëse. Ndotja e ujit dhe tokës, legjislacioni dhe ndotja. Ndotja akustike-zhurma ,krahasimi i ndotjes në komunikacionin rrugor, ajror dhe hekurudhor.			
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmi i Komunikacionit edhe mjedisi			
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të lëndës studentët do të: - fitojnë njohuri themelore në lidhje me ndotjen nga trafiku, - janë të aftë të bëjnë analiza e përgjithshme e ndotjes në mjedisi, -kuptojnë mundësinë e reduktimit të ndotjes nga transporti rrugor, -kuptojnë legjislacionin mbi ndotjet e ambientit: -kuptojnë konsekuencat nga ndotja akustike, nga zhurmat, ndotja nga transporti ajror, rrugor dhe hekurudhor.			
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)				
Aktiviteti	Orë	Ditë	Javë	Total
Ligjërata	2	15	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15		15
Punë praktike	2	2	2	4
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4	4
Ushtrime në teren	1	4	4	4
Kollokfiume,seminare	2	3		6
Detyra të shtëpisë	2	4		8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	4		8
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4		20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2		4
Projektet,prezentimet ,etj	1	6		6
Totali				110
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezenteve, detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime			
Raporti teori/praktikë:	90/10			
Metoda e vlerësimit:	Vlerësimi i parë intermediar: 20% Detyrat seminarike: 25% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 50%; Total 100%			
Literatura bazë:	[1] William R. Black. <i>Sustainable transportation, problems and solutions</i> . The Gulifort Press, 2010 [2]. Demidov, S, Bonnet,J. <i>Traffic Related Air Pollution and Internal Combustion Engines</i> ,BN, NY. 2009 [3] Limani Y. (2017) Komunikacioni dhe Mjedisi (Ligjerata të autorizuar). FIM, Prishtinë [4] Muriqi A. (2012) Komunikacioni dhe mjedisi,(ligjerata të autorizuar), FIM, Prishtinë			
Literatura shtesë:	EC (2016). Environment. [Online] http://ec.europa.eu/environment/air/transport/road.htm EEA (2017). Transport. [Online] http://www.eea.europa.eu/themes/transport/intro			

Titulli i lëndës:	LOGJISTIKA NË KOMUNIKACION		
Përshkrimi i lëndës	Definimi dhe struktura e logjistikës. Proceset e logjistikës së transportit. Logjistika në funksion të planifikimit, kontrollimit dhe organizimit efektiv dhe eficient të qarkullimit të njerëzve dhe mallrave. Zhvillimi i logjistikës operacionale në organizatat ndërmarrëse. Sub-sistemet në logjistikën e transportit. Analizimi i proceseve teknologjike gjatë transportit. Aplikimi i teknologjive moderne tek ndërlidhja e llojeve të ndryshme të transportit, etj.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentit që me njohuritë e përvetësuar të jetë në gjendje të kuptoj dhe të analizoj: - proceset e planifikimit, kontrollimit dhe efikasitetin e qarkullimit të njerëzve dhe të mallrave, - proceset e përzgjedhjes së metodave adekuate përmes së cilave arrihet optimalizimi i transportit.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde pritet që studenti do të jetë në gjendje të: <ol style="list-style-type: none"> 1. njohë metodat dhe modelet që përdoren për optimalizimin e transportit, 2. jetë në gjendje të përzgjedh lokacionet dhe hapësirat adekuate përmes së cilave mundësohet rritja e efikasitetit të transportit, 3. mësojë si ti aplikojë këto metoda dhe modele për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të transportit në praktikë, 4. analizojë dhe krahasojë rezultatet midis metodave dhe modeleve të ndryshme në shembuj konkret, 5. zgjedhë metodën apo modelin që jep rezultate më optimale. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	2	4
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	7	7
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	3	5	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet, prezentimet ,etj	3	5	15
Totali			154
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezenteve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
Raporti praktikë/teori	40/60		
Metoda e vlerësimit:	Vlerësimi i parë intermediar: 20%; Detyrat seminarike: 25%; Vijimi i rregullt 5%; Provimi final 50%; Total 100%		
Literatura bazë:	<p>[1] Gianpaolo Ghiani, Gilbert Laporte and Roberto Musmanno, Introduction to Logistics Systems Planning and Control, JohnWiley & Sons Ltd, The Atrium, Southern Gate, Chichester, England 2004.</p> <p>[2] Per Andreasson,Viktoria Arndt and Marcus Nylander, Logistics and Transport Management, Master Thesis, Göteborg University 2004.</p> <p>[3] Psaraftis, Harilaos N. <i>Green Transportation Logistics</i>. Springer 2016.</p> <p>[4]John J. L. <i>Supply chain management and transport logistics</i>. Routledge, 2012.</p> <p>[5] Limani Y. Logjistika e transportit. Ligjerata të autorizuar, FIM, 2017, Prishtinë.</p>		
Literatura shtesë:	[6] Dr.Thomas Goldsby and Robert Martichenko, Lean Six Sigma Logistics – Strategic Development to Operational Success, J. Ross Publishing, USA 2005		

Titulli i lëndës:	TEORIA E LËVIZJES SË AUTOMJETEVE		
Përshkrimi i lëndës	Klasifikimi i automjeteve sipas ECE, Performancat e automjeteve, Karakteristikat teknike, Rrotat dhe pneumatikët, Procesi i transmetimit të fuqisë, Sistemi dhe procesi i frenimit Sistemet e avancuara elektronike		
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me klasifikimin e automjeteve sipas normave evropiane, Ndërtimin e rrotave dhe pneumatikëve, karakteristikat e tyre teknike, Forcat dhe rezistencat të cilat veprojnë në automjet, Procesi i frenimit, forcat e frenimit.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> - Të njoh llojet e automjeteve, rolin e tyre, proceset te cilat i kryejnë etj, - Të bëjë kalkulimin e karakteristikave teknike, - Të bëjë kalkulimin forcave te jashtme, forcave rezistuese, - Të bëjë kalkulimin forcave dhe momenteve te frenimit 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit)			
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithësejt
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	5	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	10	1	10
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	10	50
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	1	5
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
Totali			165
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezentimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:	Pjesa teorike	Pjesa praktike	
	50%	50%	
Literatura bazë:	1.Dr. sc. Hestet Cakolli, Teoria e lëvizjes së automjeteve, Prishtinë, 2010 2.Dr. sc. Hestet Cakolli, Teoria e lëvizjes së automjeteve, Praktikum, Prishtinë, 2009 3. Reza N. Jazar, Vehicle Dynamics Theory and Application ,Manhattan College,2008		

Titulli i lëndës:	ANALIZA DHE MODELIMI I SISTEMEVE TRANSPORTUESE		
Përshkrimi i lëndës	<p>Në këtë modul studenti arrin të krijoj njohuri për të bërë analiza dhe për të përdorur metoda dhe modele të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve të transportit, si dhe metodat që variojnë nga modelet e thjeshta deri në ato më komplekse.</p> <p>Sistemet teknologjike dhe teoria formale e sistemeve të përgjithshme. Koncepti i sistemit të transportit, zhvillimi i sistemit të transportit dhe klasifikimi i tyre. Izoformizmi dhe Homoformizi. Sjellja , struktura dhe programet e sistemit të transportit. Modelimi i sistemit. Metodologjia e zhvillimit të softuerit. Kërkesat funksionale. Analiza , konstruktimi dhe testimi i sistemit. Gjuha e Unjësuar e Modelimit (UML-Unified Modeling Language), përshkrimi formal i sistemit. Ilustrimi i përdorimit të sistemit. Diagrami i klasifikimit, Klasifikimi, Objektet, Konsistenca. Çiftëzimi, krahasimi dhe gjeneralizimi i klasifikimit.</p> <p>Diagrami i bashkëpunimit/kooperimit. Diagrami i interaksionit. Diagrami i aktivitetit. Diagrami i gjendjes. Diagrami i performances. Simulimi softuerik. Inxhinierimi sistematik. Mbështetja e menaxhimit të teknologjisë së informacionit të sistemeve të transportit.</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Objektivi kryesor i kësaj lënde është të japë kuptim të gjerë në aspekte të ndryshme të sistemeve të transportit, duke i siguruar një pasqyrë të fortë për të bërë analiza dhe modele të sistemeve të transportit. Moduli do të përdorë mënyra të ndryshme për të aplikuar konceptet teorike dhe analitike të paraqitura në ligjërata dhe në lexime.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të lëndës, nga studenti pritet që të aftësohet që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të arrin njohuri mbi metodat dhe modelet që përdoren në sistemet transportuese; - të mësoi se si të i aplikojë këto metoda dhe modele për zgjidhje e problemeve të ndryshme të transportit në rastet e hapura dhe në ato të mbyllura - të realizoj analiza dhe krahasime të rezultateve midis metodave dhe modeleve të ndryshme me shembuj konkret duke aplikuar ato në rrjetin e transportit. - Të realizojë punë praktike duke rezultuar në zgjidhje të problemit praktik, ku studenti zgjedhë detyrat individualisht. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	2	4
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	1	10	10

Kollokfiume,seminare	8	1	8
Detyra të shtëpisë	2	9	18
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	10	40
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	1	2
Totali			156
Metodologjia e mësimeve:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, ushtrime në terren, punime seminarike, teste, diskutime.		
-Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:	Pjesa teorike	Pjesa praktike	
	50%	50%	
Literatura bazë:	[1]. Möller, Dietmar P.F. <i>Introduction to Transportation Analysis, Modeling and Simulation</i> . Springer,2014. [2]. Cascetta E. <i>Transportation System Analysis: Models and Applications</i> . Springer,2009. [3]. Limani Y. Modelimi i sistemeve të transportit, ligjërata të autorizuara, FIM Prishtinë, 2017.		
Literatura shtesë:	[4]. Shpëtim Shehu, Kërkime Operacionale - Universiteti Politeknik Tiranë & PEGI, Tiranë 2004. [5]. 3.Todoroviq D. Transport mreze, Saobraqajni Fakultet, Beograd, 2006.		

Titulli i lëndës: AUTOBAZAT DHE AUTOSTACIONET			
Përshkrimi i lëndës	Shkaku i parkimit, kohëzgjatja e parkimit, sipërfaqen e parkimit në funksion të dimensioneve të mjeteve transportuese, mënyra e parkimit, metodat për përcaktimin e sipërfaqes optimale për parkim, metodat e parkimit, metodat për përcaktimin optimal të sipërfaqeve të parkimit. Bazat teknologjike të stacioneve të autobusëve. Metodatat për llogaritjen e kapacitetit prej elementeve në stacionet e autobusëve. Organizimi i parkimit, parking garazh, serviset, stacionet e automjeteve dhe e autobusëve dhe rregullimin e objekteve brenda tij.		
Qëllimet e lëndës:	Qe ti aftësoj studentet ne njohjen shkakut te parkimit, kohëzgjatjen e parkimit, sipërfaqen e parkimit ne funksion te dimensioneve te mjeteve transportuese, mënyrat e parkimit, metodat për caktimin e sipërfaqes optimale për parkim. Ti njoh kriteret e nevojshme dhe metodat për caktimin e nevojës për parkim dhe mënyrat e zgjedhjes se problemit te parkingut. Bazat teknologjike te tërësisë se stacionit te autobusëve. Metodatat e llogaritjes se kapacitetit te elementeve te veçanta ne stacionin e autobusëve. Organizimin e parkingjeve, parking garazheve, serviseve, autostacioneve dhe autobazave si dhe rregullimin e objekteve brenda tyre.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"> 1. ti njoh elementet e nevojshme për një projekt teknologjik për parkingje te hapura dhe ta punoj projektin e tillë, 2. ti njoh elementet e nevojshme për një projekt teknologjik për parking garazha dhe ta punoj projektin e tillë, 3. ti njoh elementet e nevojshme për një projekt teknologjik për autobaza dhe autostacione. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	2	4
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	10	2	20
Detyra të shtëpisë	0	0	0
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	10	50
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj	4	1	4
Totali			164
